ISMAIL KADARE: AN ALBANIAN UNIVERSE THROUGH THE LENS OF FRENCH CRITICISM

ISMAIL KADARE: NJË UNIVERS SHQIPTAR NËN VËSHTRIMIN E KRITIKËS FRANCEZE

Ardian RAMADANI

ITSHKSH- Shkup & Ambasada e Francës në Shkup dhe Instituti Francez
ardian.ramadani2015@gmail.com

Abstract

This paper examines the place occupied by Ismail Kadare within the French literary and cultural landscape, focusing on the various ways in which his work and intellectual figure have been read, interpreted, and critically assessed in France. Particular attention is devoted to the perspectives of Jean-Paul Champseix, Élisabeth Champseix, Anne-Marie Autissier, Véronique Gély, Éric Faye, Louis-Dominique Lavigne, and Stéphane Aucante, whose readings, analyses, and reflections have highlighted the literary, aesthetic, philosophical, and civic dimensions of the Albanian writer.

The study also considers Kadare's emergence and subsequent recognition within French literary circles, with particular emphasis on *The General of the Dead Army*, a novel that marked an important stage in his encounter with an international readership. In this context, the paper explores the resonance of Kadare's writing among French literary and intellectual circles, as well as the decisive role played by translation, literary criticism, and cultural mediation in establishing his reputation beyond the boundaries of Albanian literature.

Through an examination of the assessments offered by prominent French writers and scholars, the paper seeks to foreground one of the most significant aspects of Kadare's literary achievement: his capacity to produce literature of enduring artistic value within the restrictive conditions of a totalitarian system. From this perspective, his writing may also be understood as a distinctive form of literary dissent, in which resistance to ideological and political power is not necessarily expressed directly, but rather through metaphor, allegory, myth, and the broader resources of literary imagination.

French interpretations of Kadare frequently emphasise the complexity of his artistic universe, where history and myth, memory and tragedy, the grotesque and individual experience intersect to acquire universal significance. Through these dimensions, Kadare emerges not merely as a writer bearing witness to a particular historical and political reality, but also as a writer of freedom, intellectual courage, and spiritual resistance in the face of ideological pressure.

The paper further argues that Kadare's oeuvre, while constituting a major achievement of Albanian literature, has also served as a powerful cultural bridge between Albanians and the wider world. This role is particularly evident in France, where his work gained considerable literary recognition and contributed to establishing him as one of the respected voices of contemporary European literature. From this perspective, literature does not necessarily overthrow political regimes directly; rather, it exposes their mechanisms, dismantles their myths, and strips them of their illusions. Likewise, one of the most enduring forms of dissent may be that articulated through art and the written word.

Kadare's case also demonstrates that the cultural stature of a people cannot be measured solely by geographical or demographic dimensions. When a culture succeeds in communicating with the world through a major writer, it acquires a visibility that transcends its own borders. In this sense, Kadare gave Albanian literature and culture a powerful presence in the international arena and, more specifically, within the European cultural sphere.

Ultimately, the paper seeks to demonstrate that great literature does not emerge from creative talent alone, but also from the profound tension between the individual, history, and the age in which one lives. In such a confrontation, the writer is not merely a chronicler or witness of his time, but may become one of its deepest forms of conscience. It is precisely in this respect that Ismail Kadare's oeuvre transcends the historical and geographical circumstances from which it emerged: it is not simply the literary reflection of an era, but an enduring artistic universe that continues to speak beyond it.

Keywords: Ismail Kadare; Albanian literature; French reception; literary dissent; cultural mediation.

Abstrakt

Ky punim synon të shqyrtojë vendin që Ismail Kadare zë në perceptimin letrar dhe kulturor francez, duke analizuar mënyrat e ndryshme në të cilat krijimtaria dhe figura e tij janë lexuar, interpretuar dhe vlerësuar në Francë. Në qendër të trajtesës vendosen këndvështrimet e Jean-Paul Champseix, Élisabeth Champseix, Anne-Marie Autissier, Véronique Gély, Éric Faye, Louis-Dominique Lavigne dhe Stéphane Aucante, personalitete të cilët, përmes leximeve, analizave dhe reflektimeve të tyre, kanë nxjerrë në pah përmasën letrare, estetike, filozofike dhe qytetare të shkrimtarit shqiptar.

Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet hyrjes dhe afirmimit të Kadaresë në hapësirën letrare franceze, veçanërisht përmes romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", i cili përbën një pikë të rëndësishme në rrugëtimin e tij drejt lexuesit ndërkombëtar. Në këtë kuadër do të shqyrtohet jehona që krijimtaria kadareane pati në qarqet intelektuale dhe letrare franceze, si dhe rëndësia që patën përkthimi, kritika dhe ndërmjetësimi kulturor në ndërtimin e reputacionit të tij përtej kufijve të letërsisë shqipe.

Përmes analizimit të vlerësimeve të studiuesve dhe letrarëve të njohur francezë, punimi synon gjithashtu të evidentojë një nga veçoritë më domethënëse të Kadaresë: aftësinë për të krijuar letërsi të përmasave të mëdha brenda realitetit të një sistemi totalitar. Në këtë kontekst, krijimtaria e tij mund të lexohet edhe si një formë e veçantë e kundërshtimit letrar, ku përballja me pushtetin dhe ideologjinë nuk artikulohet gjithmonë drejtpërdrejt, por përmes fuqisë së metaforës, alegorisë, mitit dhe gjuhës artistike.

Në leximet franceze spikat veçanërisht universi kompleks kadarean, në të cilin historia dhe miti, kujtesa dhe tragjikja, grotesku dhe drama individuale ndërthuren për të marrë një kuptim universal. Përmes këtyre dimensioneve, Kadareja shihet jo vetëm si shkrimtar që dëshmon për një realitet të caktuar historik e politik, por edhe si autor i lirisë, i guximit intelektual dhe i qëndresës shpirtërore të individit përballë trysnisë ideologjike.

Trajtesa synon të argumentojë se krijimtaria e Ismail Kadaresë, përveçse përfaqëson një nga pasuritë më të rëndësishme të letërsisë shqipe, ka luajtur edhe rolin e një ure të fuqishme kulturore ndërmjet shqiptarëve dhe botës. Kjo është veçanërisht e dukshme në Francë, ku vepra e tij fitoi një vend të rëndësishëm në jetën letrare dhe e bëri autorin shqiptar një prej zërave të respektuar të letërsisë bashkëkohore evropiane. Në këtë perspektivë, letërsia nuk paraqitet domosdoshmërisht si një forcë që përmbys drejtpërdrejt regjimet, por si një fuqi që ua zbulon mekanizmat, ua çmonton mitet dhe ua zhvesh iluzionet. Po kështu, kundërshtimi më jetëgjatë mund të jetë pikërisht ai që artikulohet përmes artit dhe fjalës së shkruar.

Rasti i Kadaresë dëshmon njëkohësisht se përmasat kulturore të një populli nuk përcaktohen vetëm nga madhësia e tij gjeografike apo demografike. Kur një kulturë arrin të komunikojë me botën përmes një shkrimtari të madh, ajo fiton një dukshmëri që i kapërcen kufijtë e saj. Në këtë kuptim, Kadareja i dha letërsisë dhe kulturës shqiptare një prani të fuqishme në opinionin ndërkombëtar dhe, në mënyrë të veçantë, në hapësirën kulturore evropiane.

Në përfundim, punimi mëton të dëshmojë se letërsia e madhe nuk buron vetëm nga talenti krijues, por edhe nga tensioni i vazhdueshëm ndërmjet individit, historisë dhe kohës në të cilën ai jeton. Në një përballje të tillë, shkrimtari nuk mbetet thjesht kronikan apo dëshmitar i epokës së vet, por mund të shndërrohet në një prej ndërgjegjeve të saj më të thella. Pikërisht në këtë rrafsh, krijimtaria e Ismail Kadaresë i tejkalon kufijtë e kohës dhe të hapësirës që e prodhuan: ajo nuk është vetëm dëshmi letrare e një epoke, por një univers artistik që vazhdon t'i drejtohet njeriut përtej saj.

Fjalë kyçe: Ismail Kadare; letërsia shqipe; receptimi francez; disidenca letrare; ndërmjetësimi kulturor.

Hyrje

Për Ismail Kadarenë është folur dhe shkruar gjerësisht që në të gjallë të tij, ndërsa figura dhe krijimtaria e tij kanë qenë vazhdimisht objekt vlerësimesh, interpretimesh dhe qëndrimesh nga më të ndryshmet. Rreth emrit të tij janë ndërtuar perceptime shpeshherë të kundërta: nga admirimi dhe ngritja pothuajse në përmasat e një miti letrar, deri te kritikat e ashpra, kundërshtimet dhe, jo rrallë, denigrimet. Për të kanë shkruar njerëz të letrave dhe studiues të letërsisë, por kanë dhënë gjykime edhe persona që nuk kanë pasur ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me botën letrare. Megjithatë, përtej debateve, polemikave apo gabimeve që mund ta shoqërojnë çdo njeri dhe çdo krijues, mbetet vështirë të vihet në diskutim pesha e jashtëzakonshme që Kadareja ka fituar në letërsinë shqiptare. Madje, rëndësia e tij i ka kapërcyer prej kohësh kufijtë e saj.

Prania e veprës së Kadaresë në rreth 45 gjuhë të botës përbën në vetvete një dëshmi të fuqishme të shtrirjes së tij ndërkombëtare. Një përhapje e tillë e krijimtarisë së tij e vendos autorin

shqiptar në një hapësirë letrare shumë më të gjerë dhe dëshmon se vepra e tij ka arritur të komunikojë me lexues, kultura dhe tradita të ndryshme.
Një pikë vendimtare në këtë rrugëtim ishte romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur, vepër që luajti rol thelbësor në afirmimin e Kadaresë si shkrimtar përtej hapësirës shqiptare. Pas tij do të pasonin një varg veprash të tjera që do ta konsolidonin gjithnjë e më shumë profilin e tij letrar. Megjithatë, pikërisht "gjenerali" i tij do të shënonte një kthesë të veçantë. Depërtimi i këtij romani në Francë, përmes përkthimit të Jusuf Vrionit[1] hapi një etapë të re jo vetëm në krijimtarinë dhe karrierën ndërkombëtare të Kadaresë, por, në një kuptim më të gjerë, edhe në mënyrën se si letërsia shqiptare filloi të bëhej e pranishme dhe të perceptohej jashtë kufijve të saj.
Përzgjedhja e figurës së Ismail Kadaresë si objekt i kësaj trajtese lidhet, pra, së pari me përmasën e tij të jashtëzakonshme si personalitet letrar dhe kulturor. Mirëpo, ekziston edhe një arsye e dytë, e cila buron nga përvoja ime profesionale dhe kontakti i drejtpërdrejtë me mjedisin frankofon. Duke pasur rastin të shërbej si përkthyes dhe interpret në gjuhën shqipe dhe frënge për tre ambasadorë të Francës në Maqedoninë e Veriut, si dhe duke përkthyer publikime për Ambasadën e Francës dhe Institutin Francez në Shkup, kam mundur të vërej nga afër mënyrën se si perceptohet kultura shqiptare në këtë hapësirë.
Nga bisedat dhe shkëmbimet e vazhdueshme me diplomatë, ambasadorë dhe miq frankofonë, një emër është shfaqur pothuajse në mënyrë të pandryshueshme si pikë referimi kur bëhet fjalë për shqiptarët: Ismail Kadare. Pa pretenduar se po zbulohet këtu ndonjë e panjohur, përvoja ime dëshmon se, për një pjesë të konsiderueshme të bashkëbiseduesve francezë dhe frankofonë, Kadareja ka funksionuar si një lloj pasaporte kulturore e shqiptarëve drejt botës. Përmes veprës dhe personalitetit të tij, ata kanë krijuar një nga kontaktet e para dhe më të fuqishme me kulturën, historinë dhe identitetin shqiptar. Në këtë kuptim, Kadareja nuk përfaqëson vetëm një individualitet të madh letrar, por edhe një figurë përmes së cilës kultura shqiptare është bërë më e dukshme, më e lexueshme dhe më e njohur në hapësirën kulturore franceze dhe më gjerë.


Kadareja dhe letërsia e tij në Francë

Emri i Ismail Kadaresë në Francë hyri përmes veprës së tij monumentale « Gjenerali i ushtrisë së vdekur », për të vijuar më tej me veprat tjera, përfshirë edhe romanin « Dimri i Madh », libër ky që e pasqyronte Shqipërinë si fitimtare për ndarjen e saj nga kampi socialist i udhëhequr nga Moska, e në anën tjetër popullin shqiptar si qëndrestar ndaj perandorive të mëdha pushtuese, Roma, Kostandinopoja, Stambolli, si dhe nga Moska (e ashtuquajtura Roma e Tretë).
Libri « Gjenerali i ushtrisë së vdekur » në mesin e letërsisë franceze u bë i njohur dhe i admirueshëm, sepse pikërisht në atë kohë në Europë, e sidomos në Francë, mbizotëronte një klimë kundër kolonializmit, e ky libër i Kadaresë u kundrua si vepër që ngërthente frymën antikolonialiste, ndërsa « Dimri i Madh » zgjoi kërshërinë e publikut dhe lexuesve, si dhe u prit mirë, ngase një Shqipëri aq e vogël, të braktiste një bllok aq të madh sikurse BRSS-ja, ishte vërtetë e paimagjinueshme.
Në fillim të vitit 1970, ishte shtëpia botuese franceze "Albin Michel", që botoi në frëngjisht romanin « Gjenerali i ushtrisë së vdekur » (fr. Le Général de l'Armée Morte). Ky ishte një sukses i madh në Francë, sepse e njëjta vepër do të përkthehej shumë shpejt në gati 20 gjuhë në tre vjet.2 Libri u ekranizua në vitin 1983 nga Luciano Tovoli me aktorët Marcello Mastroianni dhe Michel Piccoli. 3

[1] E përmuajshmja mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore "SHENJA", Viti XIII, nr. 160, gusht 2024, Artikulli me titull "Intelektuali publik nr.1", nga Enis Sulstarova, fq. 9
[2] https://kosovapress.com/fr/si-lindi-dashuria-per-letersine-dhe-krijimtaria-e-pasur-e-ismail-kadarese, korrik 2024.
[3] https://www.radiofrance.fr/franceculture/podcasts/affinites-electives/ismail-kadare-3033357

Më pas Kadareja iu rrek edhe temave historike. Shkroi dhe botoi romanet “Kështjella” (1970) dhe “Kronikë në gur” (1971), të cilat u shfaqën njëri pas tjetrit në Francë. Gjatë këtyre viteve ai drejtoi edhe të vetmen revistë në gjuhë të huaj të Lidhjes së Shkrimtarëve, “Les lettres albanaises”. 4
Pasi u largua nga Tirana dhe kërkoi azil politik në Francë, ai mundi të ushtronte profesionin e tij në liri të plotë. Mërgimi i tij në Paris ishte i frytshëm dhe i mundësoi suksese të reja, si në shqip ashtu edhe në frëngjisht.
Në vitin 1996, ai u pranua në Akademinë Franceze të Shkencave Sociale dhe Politike, ku zëvendësoi filozofin Karl Popper. Nga viti 1994 deri në vitin 2004, shtëpia botuese franceze “Fayard” botoi veprat e plota të Kadaresë në frëngjisht dhe shqip. Gjatë viteve '90, ai kontribuoi në botimin e autorëve të shumtë shqiptarë në Francë, qoftë duke i propozuar botuesve francezë autorët shqiptarë, qoftë duke ua shkruar parathëniet e librave të tyre.

Ismail Kadare : një disidencë letrare



Autori francez Jean-Paul Champseix (shq. Zhan-Pol Shamse), pedagog i letërsisë moderne, që ka kryer doktoraturën në temën « Figura e bretonit në letërsinë frënge », si dhe një disertacion të dytë me titull « Vepra e Kadaresë », është një autor i njohur francez, i cili trajton figurën e Kadaresë dhe veprën e tij. Champseix, si i kualifikuar për të drejtuar kërkime në letërsinë krahasuese, ka dhënë mësim letërsinë frënge në Universitetin e Tiranës nga viti 1982 deri në vitin 1988. [5]
Në librin e tij « Ismail Kadare : një disidencë letrare », botuar nga shtëpia botuese « Champion », më 2019, Champseix e pasqyron letërsinë e Kadaresë si në vijim : « Ismail Kadareja arriti të ndërtojë një vepër të papritur në një vend, që ishte njëri nga më totalitarët. Ai iu shmang dogmave të realizmit socialist dhe nëpërmjet strategjive letrare e ideologjike, hyri (pa mos e vrarë mendjen, shënim i autorit të punimit shkencor) në disidencë. Këto romane, në cilëndo qoftë periudhë që janë vendosur, denoncojnë mizorinë e shoqërisë staliniste të asaj kohe, përderisa po fosilizohej regjimi që ngërthente këtë frymë. »
Shqipëria ishte njëri nga vendet më totalitare në planet. Megjithatë, Ismail Kadareja arriti të ndërtojë një vepër të papritur në këtë regjim të qeverisur me grusht të hekurt nga Enver Hoxha. Shkrimtari, jo vetëm i shmangu dogmat e realizmit socialist, por ia doli që, nëpërmjet strategjive letrare dhe ideologjike, të hynte në disidencë. Këto romane të tij, na kthejnë në

[4] Po aty
[5] https://www.amazon.com/ISMA%C3%8FL-KADAR%C3%89-DISSIDENCE-LITT%C3%89RAIRE-BIBLIOTHEQUE/dp/2745349562

epokën e diktaturës komuniste. Aty denoncohen veçanërisht arbitrariteti i pushtetit, shkelja e njerëzve, ankthi i përgjithësuar, shkatërrimi moral i shoqërisë dhe rrënimet, si pasojë e revolucionit kulturor. Paradoksi është se, në këtë vend "nacional-komunist", ishte suksesi i arritur në Francë ai që kontribuoi në bërjen e Kadaresë në "shkrimtar kombëtar". Ai mori kritika dhe kërcënime nga Ministria e Brendshme e asaj kohe dhe Partia e Punës. Megjithatë, vepra e tij u botua vazhdimisht. Një vepër e tillë ishte e mjegullt në një sistem të tillë dhe vetë Kadareja vë në dyshim statusin e tij të, që e bëri atë të tolerohej nga diktatori », përfundon Champseix.
Pas vdekjes së Ismail Kadaresë, i njëjti autor, më 05 korrik 2024 shkroi një artikull ku lartësoi figurën e Kadaresë në piedestal. Ai shkoi artikullin « Një penë kundër bunkerëve », [6] ku theksoi se Kadareja ngjalli xhelozinë në botën e vogël letrare - të cilën ai do ta përshkruante si një "det i kripur. Madje, më keqdashësit do të theksonin se suksesi i tij në Francë ishte provokuar artificialisht.
Autori Champseix thekson se kultura e Kadaresë - e cila e imunizoi atë - i ka rrënjët në universet letrare që e magjepsën vet shkrimtarin dhe që ai i konsideronte si të shenjta. Në panteonin e veprës së Kadaresë, sipas Champseix, janë Eskili, Homeri, Shekspiri, Dante, Servantesi, Gogoli si dhe Kafka, të cilët ai mundi t`i lexonte gjatë qëndrimit të tij në Moskë. Legjendat shqiptare, të cilat regjimi komunist donte t'i zhdukte si "mbijetesa arkaike dhe supersticioze", ishin gjithashtu thelbësore për të, sepse ai i konsideronte ato si vorbull të urtësisë së madhe. Champseix thekson se « Vepra e Kadaresë mbart historinë e vendit të tij, por, për fat të mirë, ajo shkon përtej saj me universin e fortë dhe poetik letrar që përdor ai ». Sipas Champseix, përderisa Hoxha, në një çmenduri të pashoq, mbuloi vendin e tij me qindra mijëra bunkerë, Kadareja u përpoq ta bënte të njohur vendin e tij të vogël përmes vlerave letrare.
Në librin tjetër të po të njëjtit autor, në bashkëautorësi me bashkëshorten e tij Elisabeth Champseix [7], ku ata flasin për vajtjen e tyre dhe qëndrimin në Tiranë në vitin 1982, në cilësi të pedagogëve të frëngjishtes, libër ky që ka titullin « Bulevardi Stalin nr. 57 », i përkthyer në vitin 2015 nga shtëpia botuese « Papirus », në kapitullin 13, autorët analizojnë në mënyrë të thuktë veprën e Kadaresë. Në kapitullin e titulluar "Kadareja ose liria e brendshme", ai thekson se Shqipëria (atdheu i Kadaresë) është në qendër të të gjitha librave të Kadaresë. Si te "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kështjella", "Kronikë në gur", "Dimri i madh", "Kamarja e turpit", "Kush e solli Doruntinën", e kështu me radhw, temë qendrore zë atdheu i tij, legjendat, qyteti i tij i lindjes, thjesht mëmëdheu. Sipas autorëve, arti i Kadaresë qëndron në një përzierje të hollë mes realitetit dhe miteve. [8]
Autorët, çifti bashkëshortor Champseix, theksojnë se vepra e Kadaresë nuk përkonte me parimet e realizmit socialist, si dhe se suksesi i tij u bë shkak për ta kritikuar vazhdimisht atë se gjoja ai dashka t`u pëlqente të huajve, me demek botës "borgjezo revizioniste". Autorët, shpalosin hollësitë kur më 1983, ambasadori i Francës kishte shtruar një koktej për të festuar nisjen për në Paris të një delegacioni shkrimtarësh dhe intelektualësh shqiptarë, e ku Kadareja ngjante si mbi gjemba, për shkak se mbikëqyrej nga rivali i tij i pafat, por shumë më i fuqishëm, Dritëro Agolli, i cili ndihej i tërbuar kur shihte se si Kadareja dilte në pah dhe merrte namin ndërkombëtar. Por, autorët theksojnë se edhe ishte tejet e vështirë të bisedoje me Kadarenë, sepse ishte i rezervuar dhe përgjigjej shumë shkurtë. Por, që i kishte pëlqyer fakti se autorët e këtij libri ia kishin lexuar të gjitha librat e tij, këtë nuk e fshehte dot si ndjesi. Sipas autorëve, Kadareja konsideronte veten krijues të ngadaltë, i cili shkruante përditë, por duke mos ndenjur më shumë se dy orë në tryezë. Sipas autorëve, të shkruarit për Kadarenë ishte asketizëm, ku i kërkohej përqëndrim dhe kontroll i plotë i vetes. Sipas tyre, Kadare nuk kishte ndonjë libër të

[6] https://www.en-attendant-nadeau.fr/2024/07/05/une-plume-contre-des-bunkers-ismail-kadare/
[7] Elisabeth Champseix, pedagoge e letërsisë moderne, ka kryer dy doktoratura "Përralla e Bretanjës" dhe "Vendi që zënë kopshtet ne letërsi". Është e specializuar në fushën e mësimdhënies së gjuhës frënge për të huajt, si dhe drejton DELCIFE (Katedrën për Mësimdhënien e Gjuhës, Kulturës dhe Institucioneve Franceze për të Huajt) në Universitetin Paris-Est Créteil (Paris 12).
[8] Élisabeth & Jean-Paul Champseix « Bulevardi Stalin nr. 57 », Papirus, Tiranë, 2015 fq. 177

preferuar nga veprat e tij, por që shquante pak më tepër "Muzgun e perëndive të stepës", sepse aty ai tregonte kujtimet e tij personale. [9]

Në lidhje me raportin mes Kadaresë dhe pushtetit, autorët theksojnë se pushteti i kishte kërkuar Kadaresë të bënte autokritikë për faktin se të gjithë librat, përveç *Dimrit të madh*, ishin të vendosura në një të shkuar të largët, duke e parë këtë si ngurrim të tij për të shkruar për socializmin në ndërtim, mandej ai kritikohej për mitet, si dhe se e izolonte veten nga populli për shkak të intelektualizmit të tij dhe dëshirës për t`i pëlqyer "kapitalistëve". Më tutje, sipas autorëve Champseix, Kadareja shkruan me një gjuhë të veçantë që nuk ishte e pranueshme për të gjithë, duke flakur dialektizmat dhe tradicionalizmat, preferonte rendin kryefjalë, folje, kundrinë, në vend të përdorimit të sintaksës së vjetër, që e vendoste foljen në fund të fjalisë, krijonte fjalë të reja me sistemin e togfjalëshave, pasuronte shqipen. Në lidhje me Kadarenë dhe përkthimin gjuhësor, autorët theksojnë se sipas Kadaresë shqipja, me sistemin e lakimit dhe togfjalëshave, ishte më pranë gjermanishtes, se sa frëngjishtes.

Për në fund, sipas autorëve Champseix, Kadareja ishte shkrimtar i madh, por edhe burrë me guxim, i cili kisjte ditur ta ruante botën e tij krijuese dhe të mbrohej nga shkelja e pushtetit. Sipas tyre, letërsia me gjenialitetin e vet, e kishte vendosur që njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj të epokës të ishte shqiptar. [10]

Autorë të tjerë francezë, që e kanë trajtuar figurën e Kadaresë janë Anne-Marie Autissier dhe Véronique Gély, [11] që në librin e tyre « Leximi i Ismail Kadaresë", të botuar në vitin 2021, nga Shtypi i Universitetit të Paris-Nanterre (fr. Presses universitaires de Paris Nanterre), në pjesën « Ismail Kadare, analist i shoqërisë komuniste shqiptare », [12], theksojnë se në veprën e Kadaresë lexohet melankolia e një gjendjeje zhgënjyese njerëzore, të dënuar me vdekje, ashtu si rrënimet e një racionaliteti të padobishëm, e madje edhe të rrezikshëm. Sipas këtyre dy autoreve, veprat e Kadaresë do të vazhdojnë të na paralajmërojnë për rrezikun që përfaqësojmë ne për veten tonë, të dehur siç jemi nga iluzioni i zotërimit të një bote të pasigurt dhe të pakapshme.[13]

Një autor tjetër tejet i shquar francez, që ka trajtuar figurën e Ismail Kadaresë është Eric Faye[14]. Ai është njëri nga specialistët më të mirë të Kadaresë në Francë. Dy librat e tij të parë, të botuar në vitin 1991, janë njëri një monografi-ese për Ismail Kadarenë, e tjetri një përmbledhje intervistash me Kadarenë, të realizuara fillimisht në Tiranë në prill të vitit 1990, e më pas në Francë, kur, Kadareja shkoi në mërgim në fund të atij viti.

Faye ka shkruar esenë për Ismail Kadarenë, të cilin e ka titulluar « Ismail Kadare- Prometheu, zjarrmbajtës », e të cilin e lartëson dhe e vlerëson tejmase.

Në vitin 2009, ai botoi edhe një vepër tjetër, të titulluar « Ne do të kemi gjithmonë Parisin » në të cilën, duke ndjekur ecejakun e tij të mrekullueshëm që nga fëmijëria, evokon takimet e tij me shkrimtarët Ismail Kadare dhe Julien Gracq. [15]

[9] Po aty, fq. 181

[10] Po aty, fq. 194

[11] Anne-Marie Autissier, lektore e sociologjisë në Universitetin e Parisit 8, profesoreshë e asociuar e Letërsisë Moderne dhe doktoreshë në Sociologji, ajo jep mësime mbi sociologjinë e kulturës dhe politikat kulturore evropiane në Institutin e Studimeve Evropiane të Universitetit të Parisit 8 dhe kryeson shoqatën e botimeve të Culture Europe International. Është autore e veprës « Evropa e kulturës, Histori dhe sfida (Actes Sud, 2005). Në vitin 1999, ajo shkroi "Kosova në terr" dhe përktheu dhe komentoi disa tekste në shqip. Ndërsa, Véronique Gély, është profesoreshë e letërsisë krahasuese në universitetet Reims dhe Paris 10-Nanterre, pastaj, që nga viti 2008, në Paris-Sorbonë.

[12] https://books.openedition.org/pupo/3775

[13] Echenoz Jean, *Un An*, Paris, Les Éditions de minuit, 1997.

[14] I lindur në Limoges, Éric Faye është gazetar dhe autori fitues i çmimeve i më shumë se njëzet librave, duke përfshirë romane dhe kujtime udhëtimi. Ai u nderua me Çmimin e Madh të Akademisë Franceze të Romanit në 2010 për librin e tij « Nagasaki ».

[15] Julien Gracq, i lindur më 27 korrik 1910 në Saint-Florent-le-Vieil (Maine-et-Loire), ka vdekur më 22 dhjetor 2007 në Angers, është shkrimtar i njohur francez. Romani i tij i parë ishte i ndikuar fuqishëm nga romantizmi dhe surrealizmi i errët. Është autor i përkthyer në më shumë se 26 gjuhë.



Për Eric Faye, "Ismail Kadare nuk ishte vetëm një shkrimtar i shkëlqyer me shkrime shumë poetike, shumë metaforike, por edhe një mendimtar e filozof me një vizion të botës. Ai rilexoi fenomenin njerëzor por edhe historinë bashkëkohore nën dritën e miteve të lashta dhe legjendave ballkanike."

Faye për letërsinë e Kadaresë thekson : « letërsia e mirë duhet të kombinojë tragjiken dhe groteskun. Shekspiri dhe Eskili, por edhe Servantesi ishin perënditë e tij ». [16]

Faye Kadarenë e quan shkrimtar të lirisë, shkrimtar i jashtëzakonshëm evropian i harruar nga çmimi Nobel. « Ashtu si Milan Kundera, edhe Ismail Kadareja nuk do ta fitonte Çmimin Nobel për Letërsinë. Është kjo për keqardhje, e sidomos fakti se sikur ta fitonte këtë çmim, kjo do të ishte një mirënjohje e madhe për 6 milionë shqiptarë, e jo vetëm, sepse shkrimtari nuk është vetëm figurë shqiptare, por edhe njëra nga figurat më të mëdha intelektuale të kulturës europiane".

Një personalitet tjetër, i cili e ka admiruar Ismail Kadarenë, është edhe Louis-Dominique Lavigne, bashkëdrejtor artistik i teatrit « Quartier ». Ai thekson se « Unë nuk jam specialist, si Éric Faye, i autorit shqiptar, por më pëlqen stili popullor dhe modern i romaneve të tij. Ajo që admiroj te Kadareja është cilësia e vazhdueshme e punës së tij: me çdo roman të ri është gjithmonë i mrekullueshëm. Historitë e Kadaresë, të zhytura në traditën gojore, thashethemet, ritualet dhe në një kulturë të pamasë letrare, janë gjithmonë ngazëlluese. [17] "Fiksionet e tij, të mbushura me magjinë e legjendave të "tokës së shqiponjave", nga fryma e tyre unike, homerike, të mbushura me këtë kulturë të dashur të Ballkanit, ngjajnë me romanet e njohura ruse të shekullit të 19-të, apo edhe me fabulat bashkëkohore të Gabriel García Márquezit ose një Milan Kunderës", përfundon Lavigne.

Një tjetër autor, i cili është edhe i fundit, i përzgjedhur në lidhje me këtë temë, që ka shkruar për veprën e Kadaresë, është edhe Stéphane Aucante [18].

Në analizën që i bën veprës « Pallati i ëndrrave », me titull « Makthi komunist sipas një ëndrre të caktuar » ai thekson mes tjerash : « Me romanin e tij *Le Palais des Rêves* (Pallati i ëndrrave), i botuar në vitin 1981, një roman ky antitotalitar i shkruar nën një regjim totalitar, Ismail Kadare i shmanget ngushtë këtij nocioni dhe padyshim për këtë u detyrohet mbështetësve të tij të shumtë në botën perëndimore (ku ai është më i famshëm dhe më i njohur se në vendin e tij të lindjes), e ku shtjellon vuajtjet e njerëzve nga puna e detyruar në fshat, sipas mënyrës së

[16] https://www.rcf.fr/articles/culture/ismail-kadare-ecrire-pour-rester-libre
[17] https://www.ledevoir.com/opinion/idees/815996/idees-ismail-kadare-ecrivain-balkans , le 05 juillet 2024
[18] I lindur në vitin 1967, Stéphane Aucante fillimisht punoi në sektorin audiovizual. Nga viti 2002, ai ishte drejtor i objekteve kulturore në Francë. Nga viti 2015 deri në vitin 2018, ai drejtoi Institutin Francez të Nablusit, Palestinë, dhe botoi librin e tij të parë të botuar, "Nablus, Palestinë - Portrete të një pushtimi". Më pas ai inicioi tre libra kolektivë gjatë epokës së ngujimit nga virusi Covid dhe shkroi romanin e tij të parë, "Blanche, 4 herë 20 vjet në 2020". Ai sapo ka botuar librin "Pa mbulesë – Feminitet(et) në Palestinë", librin e tij të katërt lidhur me Palestinën. Në të njëjtën kohë, ai drejton rregullisht seminare shkrimi, ndër të tjera me ftesë të Labo des Histoires. Ka qenë për një kohë të shkurtër edhe drejtor i Aleancës Franceze në Tetovë.

Revolucionit Kulturor, i njohur në Kinë gjatë kohës së Mao Ce Dunit. Sipas këtij autori, Kadareja dëshironte të pasqyronte një ferr. Përpiqej të gjente diçka ambicioze, e mbase edhe kimerike (diçka me iluzione). Dhe në fakt, është e vërtetë së në këtë pallat mbizotëronte një ferr, ku ëndrrat njerëzore të zhveshura krejtësisht, asgjësoheshin, shkatërroheshin, shkërmoqeshin përfundimisht. Stéphane Aucante thekson se " nëse romani i Kadaresë i ka goditur dhe prekur aq shumë lexuesit perëndimorë, kjo është për shkak se ai prek njërin nga themelet më sublime të lirisë: të drejtën për të ëndërruar, për të shpresuar. Kjo është arsyeja, se pse ajo që përshkruhet dhe shtjellohet në libër, duket më shumë si makth.

Ky aspekt i përshkuar i makthit mund të gjendet edhe në skenën e një filmi, të viteve të 80-ta në Evropë dhe që frymëzohet tërthorazi nga romani i Kadaresë. Filmi titullohet « Brazili» nga Terri Gilliam", përfundon Stephane Aucante, duke ofruar edhe vegëzën se ku mund të shikohet filmi: https://www.youtube.com/watch?v=esSUJJmlPPI. [19].

Sipas kritikës franceze, në kontekstin ballkanik, historia ka shërbyer shpesh si një instrument për ndërtimin dhe ushqimin e narrativave nacionaliste. Pikërisht ndaj këtij fenomeni Ismail Kadare ka mbajtur një qëndrim kritik, duke sfiduar mitet historike dhe duke i trajtuar ato në mënyrë artistike përmes veprës së tij. Në disa prej romaneve të tij, si *Kamarja e turpit* dhe *Pallati i ëndrrave*, ai demaskon mekanizmat e pushtetit dhe instrumentalizimin e historisë, duke e ngritur letërsinë në një hapësirë reflektimi universal. Ky dimension kritik dhe filozofik i krijimtarisë së Kadaresë është vlerësuar edhe nga studiuesit francezë, të cilët e kanë parë atë si një shkrimtar që e tejkalon kornizën kombëtare dhe e vendos historinë në shërbim të një reflektimi më të gjerë mbi lirinë, kujtesën dhe identitetin.

Studiuesit francezë e vënë në dukje se Ismail Kadare i qaset historisë shqiptare me një këndvështrim kritik, duke u larguar nga interpretimet heroizuese dhe nacionaliste. Përmes një distance ironike dhe një humori të hollë, ai dekonstrukton mitet historike dhe i fton lexuesit të reflektojnë mbi kompleksitetin e së kaluarës. Romani *Darka e gabuar* përbën një shembull domethënës të kësaj qasjeje, pasi paraqet me finesë kontradiktat, dilemat dhe ambiguitetet që kanë shoqëruar historinë e Shqipërisë gjatë shekullit XX. Në këtë mënyrë, Kadare nuk synon të japë gjykime të thjeshtuara, por të nxisë një lexim më kritik dhe më të balancuar të historisë kombëtare. Pikërisht ky vizion është vlerësuar nga kritika letrare franceze, e cila e konsideron Kadarenë një autor që e shndërron historinë në një mjet reflektimi universal mbi pushtetin, kujtesën dhe identitetin.

Qoftë Champseix, qoftë të tjerët, e sidomos Champseix-I, e paraqesin Ismail Kadarenë si një shkrimtar që e ka tejkaluar letërsinë kombëtare dhe ka ndërtuar një univers me vlera universale. Sipas tij, Kadare nuk i përdor historia, legjendat dhe mitet për të ushqyer nacionalizmin, por për të kuptuar origjinën e tyre, për të zbuluar mekanizmat e pushtetit dhe për të nxitur reflektimin kritik mbi identitetin, kujtesën dhe fatin historik të popujve të Ballkanit. Një vend të rëndësishëm zë mënyra se si Kadare e trajton historinë shqiptare me ironi, distancë dhe shumëkuptimësi. Në romane si *Darka e gabuar*, *Dosja H*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Prilli i thyer*, *Kush e solli Doruntinën*, *Ura me tri harqe* dhe *Nëntori i një kryeqyteti*, ai demaskon mitet politike, bashkëpunimin me pushtuesit, përplasjet ideologjike dhe tragjeditë historike, duke shmangur ndarjet e thjeshta midis heronjve dhe tradhtarëve.

Sipas këndvështrimit francez Shqipëria e Kadaresë nuk është vetëm një hapësirë gjeografike, por një peizazh simbolik dhe metaforik, ku natyra, malet, mjegulla dhe legjendat bëhen pjesë e një vizioni filozofik mbi njeriun dhe historinë. Në këtë univers, kufijtë ndërmjet reales dhe mitikes shpesh treten, duke i dhënë veprës një dimension të gjerë estetik dhe kulturor.

Një tjetër element i rëndësishëm është interpretimi i origjinës së legjendave dhe i lidhjeve të kulturës shqiptare me traditën greko-romake dhe evropiane. Kadare argumenton se legjendat dhe epika nuk janë të izoluara, por pjesë e një trashëgimie të përbashkët kulturore, ndërsa gjuha

[19] 28.10.2021, bisedë e Stephane Aucante, me autorin e këtij punimi

shqipe paraqitet si një nga shtyllat themelore të identitetit kombëtar dhe si një vlerë që duhet mbrojtur.
Kritika franceze e konsideron Kadarenë një shkrimtar me përmasa evropiane dhe universale. Përmes letërsisë së tij, ai e bëri Shqipërinë të njohur për lexuesin ndërkombëtar, jo si një vend ekzotik, por si një metaforë të fatit njerëzor, të totalitarizmit, të kujtesës historike dhe të lirisë. Siç theksohet në fund të analizës, tek Kadareja "thuhet Shqipëria, por më shumë është bota", çka përmbledh më së miri perceptimin francez për veprën dhe personalitetin e tij letrar.

Përfundim

Edhe pse për Ismail Kadarenë është shkruar dhe diskutuar gjerësisht që gjatë jetës së tij, largimi i tij fizik nuk e përmbyll debatin, interpretimin dhe interesimin për figurën dhe krijimtarinë e tij. Përkundrazi, vepra që ai la pas krijon premisat që Kadareja të vazhdojë të jetë i pranishëm në jetën letrare e kulturore edhe përtej kohës së vet. Shkrimtarët e përmasave të tilla e tejkalojnë kufirin e ekzistencës fizike, sepse vazhdimësinë e tyre e sigurojnë librat, idetë dhe universi artistik që u lënë brezave. Në këtë kuptim, Kadareja vazhdon të jetojë përmes veprës së tij dhe përmes leximeve e interpretimeve të reja që ajo do të prodhojë vazhdimisht.
Këtë dimension të jashtëzakonshëm të krijimtarisë kadareane e ka përmbledhur në mënyrë domethënëse edhe poeti dhe studiuesi Agim Vinca [20], kur ka konstatuar se përmes veprave të Kadaresë bota arriti të njihte Shqipërinë dhe shqiptarët, ndërsa shqiptarëve vetë ajo u mundësoi të njihnin më thellë vetveten dhe botën. Ky vlerësim sintetizon një nga meritat më të mëdha të Kadaresë: aftësinë për ta shndërruar përvojën shqiptare në një univers letrar të komunikueshëm përtej kufijve kombëtarë, duke e bërë atë pjesë të dialogut kulturor dhe letrar botëror.
Në këndvështrimin e letrarëve dhe studiuesve francezë, por jo vetëm të tyre, Kadareja perceptohet si një autor që, në rrethanat e një sistemi të ngurtë totalitar dhe të një realiteti të deformuar nga ideologjia, synoi të krijonte një letërsi të lirë dhe me vlera universale. Në këtë frymë është formuluar edhe vlerësimi domethënës se ai “u përpoq të krijonte letërsi normale në një vend jonormal”, një përcaktim që sintetizon përplasjen ndërmjet lirisë krijuese të shkrimtarit dhe kufizimeve të realitetit politik në të cilin ai krijoi. [21]
Ndërsa, në përfundim e theksoj se njerëzit e shquar, sikurse edhe Kadareja, patjetër se pas glorifikimit, anatemimit dhe rivlerësimit, tri fazave ku detyrimisht sipas Nolit [22] kalon çdo figurë e shquar, do të mbetet edhe më tej « profeti letrar » i shqiptarëve, koka më e vlerësuar intelektuale, e ndërkaq veprat e tij do të jenë busull orientues i gjithsecilit, që dëshiron të mësojë pak e njëkohësisht edhe shumë, më hollësisht, për shqiptarët.
Krijimtaria e Kadaresë i ka dhënë letërsisë shqipe një dimension të fuqishëm ndërkombëtar, duke e bërë atë të përkthehet, të lexohet dhe të vlerësohet denjësisht përtej kufijve të hapësirës shqiptare. Përmes veprës së tij, letërsia shqipe arriti të depërtojë dhe të jetë e pranishme në qarqet më prestigjioze letrare, kulturore dhe intelektuale të Evropës dhe të botës, duke fituar një dukshmëri dhe një njohje që e vendos atë në dialog të drejtpërdrejtë me letërsitë e mëdha bashkëkohore.

[20] https://exlibris.al/wp-content/uploads/2024/07/EXLIBRIS_292.pdf
[21] https://www.lorientlejour.com/ , 17.10.2023
[22] Theofan Stilian Noli (İbriktepe, Vilajeti i Edrenesë, 6 janar 1882 - 13 mars 1965, ShBA), i njohur si Fan Noli, ka qenë dramaturg, klerik ortodoks, politikan, diplomat, njeri i letrave dhe muzikant. Si njeri i letrave, Noli ka shkruar dhe ka përkthyer tekste të shumëllojshme nga zhanre të ndryshme, si dhe ka kontribuar në publicistikën e kohës si drejtues, redaktor dhe shkrues nëpër disa të përkohshme. Nisi duke përkthyer dramaturgji, më pas përktheu Sami Frashwrin, më tutje tekste fetare ortodokse dhe vepra madhore të letërsisë botëro re nga Shekspiri, Khajami dhe Servantesi.

Referencat

[1]. Revista *SHENJA*. E përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore.
[2]. Champseix É. and Champseix J.-P., 2015. *Bulevardi Stalin nr. 57*. Papirus, Tiranë.
[3]. Champseix J.-P., 2021. *Ismail Kadare: një disidencë letrare*. Fan Noli, Tiranë.
[4]. Echenoz J., 1997. *Un An*. Les Éditions de Minuit, Paris.
[5]. KosovaPress. *KosovaPress - French edition*. Available at: https://kosovapress.com/fr/
[6]. Radio France. *Radio France*. Available at: https://www.radiofrance.fr/
[7]. Amazon. *Amazon*. Available at: https://www.amazon.com/
[8]. En attendant Nadeau. *Journal de la littérature, des idées et des arts*. Available at: https://www.en-attendant-nadeau.fr/
[9]. OpenEdition Books. *OpenEdition Books*. Available at: https://books.openedition.org/
[10]. RCF. *Radio Chrétienne Francophone*. Available at: https://www.rcf.fr/
[11]. ExLibris. *ExLibris*. Available at: https://exlibris.al/
[12]. L'Orient-Le Jour. *L'Orient-Le Jour*. Available at: https://www.lorientlejour.com/